



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e pranimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Flori Rexhepi	03.10.2025	10.10.2025	2025/0978

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 02.10.2025, OE “CONSTRUCTION GROUP SH.P.K.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2025/0978, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Rregullimi i Tregut të Hapur në Qytetin e Shtimes-Faza III” me nr. të prokurimit: "617-25-8201-5-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA SHTIME.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: 635,061.44 €.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

--

Shkeljet e LPP-se nga ana e AK-së:

Neni 1 Qëllimi, paragrafi 1 dhe 2 i LPP-së lidhur me parimet bazike nga neni 4.3 të Rregullave për Prokurim Publik;

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi, paragrafi 2, paragrafi 3 dhe paragrafi 6 pika (i), pika (iii) i LPP-së lidhur me parimet bazike 4.3 të Rregullave për Prokurim Publik

Neni 51 Njoftimi i Kritereve të Përzgjedhjes

Gjithashtu AK ka shkelur edhe dispozitat perkatëse të Rregullave të prokurimit publik.

Neni 17 paragrafi 12, dhe paragrafi 17 i Rregullorës Nr.001/2022 për Prokurim Publik

Neni 25.4 i Rregullave për Prokurim Publik lidhur me nenin 8 pika 3, pika 4 dhe pika 5 e Udhëzuesit Nr. 001/ 2023 për Prokurim Publik;

KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	Kapaciteti teknik dhe profesional:	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare</i>
		Kërkesa 3. Projekte të natyrës së ngjashme,të realizuara në tri vitet e shkuara (duke filluar nga koha e publikimit të këtij njoftimi) e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titulli i projekteve, numri, data e kontraktimit data e përfundimit dhe vlerat e tyre. Vlera minimale e të gjitha projekteve duhet të jetë, jo më e vogël se 952,592.16 €.në rast konzorciumi, lideri duhet të ketë së paku 55%	Dëshmia 3. Lista Kontratave bashkangjitura me kopjet e raporteve të pranimeve ose pranimeve ose referencave të 3 vitet e Shkuara, ku identifikohet shumën, nr. i prokurimit, vitet institucionet publike ose private personat privat. Në rast se referenca nga kompanitë private privat, të dëshmohej me tra
		Kërkesa 4. Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi se për këtë projekt do të angazhoj 1.Menaxher te projektit Inxhinier i diplomuar konstruktiv me licence me pesë vite përvojë pune pas diplomimit.	Dëshmia 4. 1.CV e nënshkruar inxhinieri, Diplomati e inxhinierit (nivele) (Becheler ose master), me punedhënesin ose marrëdhënien angazhimin per kete projekt nënshkruar nga vete inxhinieri. Dëshmia 4. 1.CV e nënshkruar inxhinieri,si dhe vërtetimin e punës pasë diplomimit.Diplomati e inxhinierit (nivele) (Becheler ose master), me punedhënesin ose marrëdhënien angazhimin per kete projekt
		Kërkesa 5. OE duhet të dëshmojë minimumin e kapacitetit të fuqisë punëtore të kompanisë	Dëshmia 5. Një pasqyrë tabele ,Mbiemri,dhe profesioni i punës duhet të dorzohet në origjin

		me të dhënat në vijim Emri , mbiemri,profesioni, minimumi 2 Punëtor operator auto vinçi telekop-autovinç te certifikuar.	dhe e vulosur nga OE, Kont të cilat duhet të jenë valide si dhe certifikata e puntorve kombetar i kualifikimeve
		Kërkesa 6.Çertifikata per kontraktorë me standarte IEC 60947-4 2029, Çertifikata standarte IEC 60947-3 2020,Çertifikata duhet te jete ne emer te OE, auturizuar ose marreveshje me ndonj kompani e cila posedon autorizimin per kete Çertifikim.	Dëshmia 6, kopjet e Çertifik autorizimit.
		Kërkesa 7. Raporti për mjetet, stabilimentet dhe paisjet teknike që janë në dispozicionin tuaj për realizimin e projektit. Një kamion me vinq me peshe ngritese min 25t me shporte me gjatesi jo me pak 27m 9me testim), Një Eskavator i deri 1t, Një Eskavator me luge rrefshuese ne dy anet me kapacitet deri 1m3 dhe tonazh min 26t, Një Cistern per pastrimin e rrugeve pesha e ngarkese se lejuar minimumi 4t.	Dëshmia 7, Lista e mjeteve nenshkruar dhe e vulosur o ekonomik duhet te ofroj list punes te nenshkruar dhe vu deshmi kopjet dud doganor Per automjetet qe registroh dokumentet te regjistrimit li autojmetet dhe testmin, Ne posedon pisjet mbi prones marreveshjen per marrejn Marreveshja duhet te jete projekti me validitet te kol kontrate e nenshkruar dhe dyja palet.
		Kërkesa 8.OE duhet të plotësoj pjesen e -V- të kontratës , Identifikimi Financiar, shkarkohet nga dosja e tenderit	Dëshmia 8.Pjesa e -V-e kon financiar,të plotësohet nënë vulozet nga OE dhe përfaqë

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

N/A

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **CONSTRUCTION GROUP SH.P.K.**

Eksperti shqyrtues, sqaron se Operatori ekonomik ankues **CONSTRUCTION GROUP SH.P.K.** me rastin e tërheqjes së dosjes së tenderit, kualifikohet si palë me interes sipas dispozitave të Nenit 4.1.26 të LPP-se.

OE ankues pasi ka analizuar kërkesat e vendosura në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë pretendon se Autoriteti Kontraktues/ **KOMUNA SHTIME**/, ka vendosur kritere diskriminuese dhe jo proporcionale në dosje të tenderit, në kundërshtim me nenin 7 të LPP-se.

Eksperti shqyrtues, sqaron se operatori ekonomik ankues me datën 19.09.2025 ka parashtruar kërkesë për Rishqyrtim, ndërsa autoriteti kontraktues me datën 23.09.2025 ka aprovuar si pjesërisht të bazuar kërkesën për rishqyrtim të OE ankues **CONSTRUCTION GROUP SH.P.K.**

Pretendimi nr. 1.

OE ankues e ankesën e tij kërkon që të ndryshohet kërkesa nr. 5 e AK-se, konkretisht pretendon se kërkesa nr. 5 për, 2 punëtorë vinqi telekop-autovinq të certifikuar është diskriminues. OE ankues pretendon se ky kriter është i pa nevojshëm dhe se kërkesa për persona të certifikuar për AUTOVINQ dhe TELESKOP të cekura nga autoriteti kombëtar i kualifikimeve të largohen ose të kërkohej vetëm persona të certifikuar për AUTOVINQ me trajnime në kompani të ndryshme.

Eksperti shqyrtues, sqaron se autoriteti kontraktues të kërkesa nr. 5 dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë ka kërkuar:

Kërkesa 5.OE duhet të dëshmojë minimumin e kapacitetit të fuqisë punëtore të

kompanisë me të dhënat në vijim Emri , mbiemri,profesioni, minimumi 2 Punëtor operator auto vinçi telekop-autovinç të çertifikuar.

Dëshmia 5.Një pasqyrë tabelare Emri,Mbiemri,dhe profesioni i punëtorit, tabela duhet të dorzohet në origjinal e nënshkruar dhe e vulosur nga OE, Kontratat e punëtorve të cilat duhet të jenë valide , ose parakontrata, si dhe çertifikata e punëtorve të akreditura kombëtar i kualifikimeve.

Lidhur me këtë pretendim ankimor, Eksperti shqyrtues, sqaron se qendron pretendimi ankimor sepse AK ka kërkuar certifikate të leshuar vetëm nga autoriteti kombëtar i kualifikimeve dhe për rrjedhojë është kufizuese si kërkesë dhe në kundërshtim me Nenin 7 të LPP-së.

Pretendimi nr. 2

OE ankues pretendon se të kërkesa nr. 7 e AK-se : Cistern për pastrim të rrugëve pesha e ngarkesës se lejuar 4 ton, dhe siç ankues nuk ka lejuar minimumin dhe maksimumin e peshës dhe kërkon që të hiqet kjo makineri e panevojshme në këtë procedurë të prokurimit ose të rritet pesha e ngarkesës se lejuar deri në 10 ton, sepse çdo makineri me të madhe mund të kryen punimet edhe pse kjo makineri është e panevojshme në këtë procedurë të prokurimit.

Poashtu pajisja : **Një kamion me vinç me peshe ngritëse min 25 ton** me shportë me gjatësi jo më pak se 27m. Sipas OE ankues, kjo makineri, ku nuk kemi të bëjë me pesha të renda sepse kjo makineri përdoret për ndërtimin e URAVE dhe punimet e suvatimit dhe estrihut sepse pesha MIN 25 ton paraqet ngarkesë 25.000 kg, ndërsa pesha e suvatimit me të larta për një paletë 1 ton, ndërsa ju kerkoni makineri për ndërtimin e urave. Ndërsa punët e paramases kanë të bëjë me suvatim, dyer, estrih pune ndërtimore për të cilën kjo makineri është tejte e panevojshme në këtë projekt. Andaj në kërkojmë të hiqet kjo makineri e panevojshme në këtë procedurë të prokurimit.

Eksperti shqyrtues, vlerëson se pretendimi i OE ankues për dy pajisjet e përmendura më lart, vlerëson se qendrojnë pretendimet e OE ankues, sepse OE ankues në ankesën e tij jep fakte dhe argumente për dy pajisjet, ndërsa autoriteti kontraktues, nuk i jep kurrfarë argumenti lidhur me këto pajisje. Gjitha ashtu në vendimin e kërkesës për rishqyrtim autoriteti kontraktues nuk ka dhënë asnjë spjegim sipas dispozitave të nenit 108/A të LPP-së.

Në vendimin e kërkesës për rishqyrtim, AK ka deklaruar se:

Ne si AK kemi analizuar kërkesën tuaj për rishqyrtim, dhe ju njoftojmë se do ta bëjmë korigjimin e këtij aktiviteti në disa pika ku konsiderojmë që duhet të korigjimi, dhe do të bëjmë zgjedhjen e afatit të dorzimit të ofertave.

Në vendim nuk ka asnjë sqarim se çfarë kërkesë ka korigjuar vetëm se ka publikuar një njoftim për permirsime të informatave dhe nuk ka ndonjë permirsim të pretendimit të OE ankues.

Eksperti shqyrtues, i rekomandon autoritetit kontraktues, që të respektojë dispozitat e Nenit 108/A dhe në përgjigje të kërkesës për rishqyrtim të operatorëve ekonomik të interesuar, të

jap përgjigje të detajuara për secilin pretendim ankimor.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “CONSTRUCTION GROUP SH.P.K.”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Rregullimi i Tregut të Hapur në Qytetin e Shtimes-Faza III” me numër të prokurimit: “617-25-8201-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA SHTIME

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KOMUNA SHTIME**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP**
- OE ankues – **CONSTRUCTION GROUP SH.P.K.**

Florije Rexhepi

